

VENDIM
Nr.86, datë 9.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.80, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE 6, ZONA KOMBINAT, BASHKIA TIRANË, DHE ÇAKTIMIN E
BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat bashkëlidhur vendimit nr.80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KUFIRI I ZONËS PËR RINDËRTIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.6 | ZONA KOMBINAT

